

Të nderuar zotërinj,

Në emër të Agna Group, kompania e parë shqiptare që ka firmosur iniciativën e Kompaktit Global, kam kënaqësinë të konfirmoj edhe një herë mbështetjen tonë për parimet e Kompaktit Global lidhur me:

1. Të drejtat e njeriut
2. Të drejtat në lidhje me punësimin
3. Mbrojtjen e mjedisit
4. Anti-korrupsionin

Me anë të kësaj deklaratë ne shprehim mbështetjen tonë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre parimeve. Ne marim përsipër të bëjmë iniciativën e Kompaktit Global dhe parimet e përfshira në të, pjesë të pandarë të strategjisë, kulturës dhe parimeve tona të biznesit.

Ju lutemi gjeni bashkangjitur në mënyrë të përmbledhur punën që kemi bërë gjatë vitit 2008 në mbështetje të këtyre parimeve.

Me respekt,

Vasil Naçi,

President

RAPORT PROGRESI

Agna Group

Tel: +355 4 2250653

Fax: +355 4 22250654

Tirane, Maj 2009

Agna Group është themeluar në vitin 1991. Kompania e saj e parë Anonime Kakvi s.a ishte ndër bizneset e para pas rënies së komunizmit.

Agna Group ka firmosur dokumentin në mbështetje të Kompaktit Global në vitin 2003, duke qenë kështu kompania e parë shqiptare në mbështetje të kësaj iniciative.

Ndër vite ne kemi mbështetur me produkte dhe ndihmë financiare kategoritë më delikate të komunitetit si fëmijët jetimë, të moshuarit pa përkrahje, familjet e policëve të vrarë, fëmijet me zhvillim të vonuar. Ndër vite i kemi kushtuar rëndësi të veçantë të punuarit me përgjegjshmëri të lartë sociale, kujdesit për mjedisin dhe forcimit të biznesit të shëndetshëm, por do të donim të ndaleshim në aktivitetet konkrete të vitit 2008.

- Agna Group ishte biznesi i parë që ofroi ndihma ushqimore për të prekurit nga tragjedia e Gërdecit të cilët u strehuan në ambjentet e Kavalehencës në Durrës. Sfafi i Agna Group, në emër të dashurisë njerëzore dhe mbështetjes për komunitetin ku jetojmë, ofroi ndihmë monetare në maratonën e organizuar në televizionin Klan përmes emisionit “*Me shumë dashuri*”, në mbështetje të familjeve të prekura nga Tragjedia e Gërdecit. Ne synuam në këtë mënyrë jo vetëm të ndihmonim financiarisht, por edhe të sensibilizonim opinionin publik në përgjithësi dhe bizneset e tjera në veçanti.

Kontribuam financiarisht në mbështetje të projektit të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptarë për ngritjen e “Qendrës Mjekësore Kombëtare të Zhvillimit të Fëmijëve”.

Në vazhdim, Agna Goup ishte ndër mbështetësit kryesorë të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara me rastin e ditës kombëtare të jetimëve, në 21 maj 2008. Agna Group

mbështeti ekspozitën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila u ekspozua në Galerinë e Arteve në Tiranë me rastin e 1 qershorit, festës së fëmijëve.

Prej tre vjetësh Agna Group është ‘Sponsor i Artë’ i Sife/Shqipëria (Studentët në Sipërmarrjen e Lirë). Përmes projekteve të tyre, studentët jo vetëm kanë mundësinë të vënë në jetë ato çfarë mësojnë në libra, por edhe të sjellin ndryshime në jetën e komunitetit ku jetojnë. Nën moton “*Nëse më jep një peshk sot do të ha një ditë, por nëse më mëson të peshkoj do të ha një jetë*”, këta studentë kërkojnë të rrisin aftësitë e njerëzve në komunitetin e tyre duke ju krijuar mundësi punësimi. Agna Group mbështet këtë iniciativë si një mundësi për të rinjtë, por edhe për komunitetet ku jetojmë.

Gjatë gjithë vitit 2008 ne kemi mbështetur skuadrën e volejbollit të të rejave të Tiranës me ndihmë financiare dhe produkte. Volejbolli është një sport shumë i dashur, por sportet në përgjithësi kanë nevojë për ndihmë në Shqipëri.

Agna Group ka qenë rregullisht pjesë e tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga UNDP në mbështetje të përgjegjshmërisë sociale, me qëllim ndarjen e eksperiencave më të përparuara mes bizneseve dhe organizatave të ndryshme që operojnë në Shqipëri.

- Agna Group ka fokus special në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve shumë cilësore. Si rezultat i përpjekjeve tona të vazhdueshme në ngritjen e standarteve, në dhjetor të vitit 2008 fabrika e Glinës u çertifikuua me ISO 9001 dhe ISO 22000 që garantojnë sigurinë dhe cilësinë në menaxhimin e prodhimit të produkteve tona, ç’ka tregon edhe një herë dedikimin tonë për cilësinë dhe përgjegjshmërinë në produktet që ofrojmë.

Në Qershor 2008, Agna Group ju akordua në Beograd çmimi “*Partner Rajonal Biznesi*” si kompania më e mirë dhe e vetme nga Shqipëria, në bazë të kriterëve të vlerësimit si: arritja e rezultateve të biznesit, aplikimi i standarteve të larta profesionale dhe etike, nderimi i partnerëve të biznesit, klientëve dhe konsumatorëve, ndihma në komunitetin ku jeton. Çmimi u akordua nga Mass Media International.

Në nëntor 2008, Agna Group ju akordua në Spanjë, nga Trade Leaders’ Club, çmimi i 24 Europian për Cilësinë, në njohje të cilësisë së lartë në prodhimin dhe tregëtimin e produkteve.

Ne kemi Kodin e Etikës së Agna Group, i cili është një ndër dokumentet themelore që specifikon sjelljen e pritshme nga punonjësit në lidhje me kolegët, partnerët, bashkëpunëtorët dhe komunitetin. Megjithatë, në programin e trajnimeve të organizuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, gjatë 2008 ne i kemi dedikuar 112 orë përgjegjshmërisë ndaj klientëve dhe mbështetjes së një biznesi etik dhe të përgjegjshëm, pasi vetë struktura jonë e operimit, me përfaqësues ekskluzivë në çdo qytet të Shqipërisë, vështirëson përcimin e të njëjtës frymë dhe mentalitet në çdo hallkë të biznesit.

- Në vitin 2008, si pjesë e "*Projektit të Ndryshimeve*" në Agna Group kemi ndërtuar një program për rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së punonjësve. Ne kemi politika të qarta punësimi për marrjen në punë të punonjësve, rritjen e kapaciteteve të tyre dhe krijimin e mundësive për rritje në karrierë. Ne promovojmë punësimin me bazë meritash, përtej paragjyqimeve me bazë gjinore, race apo besimi.

Agna Group beson thellësisht se punonjësit janë aset i saj më i rëndësishëm. Gjatë vitit 2008, Agna Group u ka dhënë mbështetje financiare 5 punonjëse të saj për të vazhduar studime pasuniversitare në nivel masteri dhe doktorature në shkollat më të mira të biznesit në Shqipëri si edhe në ato britanike, më me emër.

- Agna Group ka advokuar vazhdimisht pranë organizmave qeveritarë për të luftuar sëbashku fenomene penguese për biznesin si kontrabanda, a cila herë pas here gjen vend në Shqipëri nga individë të papërgjegjshëm.

Agna Group do të vazhdojë të punojë me këmbëngulje dhe projekte konkrete në vazhdimësi për të bërë pjesë të pandarë të strategjisë dhe implementimit të projekteve të biznesit parimet e Kompaktit Global.